

JULIA
NAÇI

E

BIBLIOTEKA

SHETIT

SJH-1

N 23

GJËROKASTËR

Ditëlindje

891.P83-1

N13


S

JULIA NAÇI

DITELINDJE

-vjersha-

~~13247~~
13829



PARTISË

Ti s'më the,
e si mund të më thoshje që këngën e parë
të ta kushtoja ty?
Po ti gjirin më dhe
ndaj nga goja ime për ty gjithë jetën do pikojë
dashuri.

Ti s'më the,
e si mund të më thoshje që këngën e parë
të ta kushtoja ty?
Po ti lirinë më dhe,
ndaj zemra ime çdo çast shpërndan nëpër deje
dashurinë për ty, o nëna e nënave Parti.

ECIM NË ASFALTIN E DRITAVE

Era i mori fjalët e tyre,
i përplasi tej, me oshëtimë.
Ata janë pjellë errësire
dhe, pas natës, si pas murit rrinë.

— Mos ki frikë — kështu më the ti —
në asfalt jemi duke ecur ne...
Dashuri e lirë, o vashë, tashti
spërkatet nga dritat kudo në Atdhe.

Kurrkush nuk i ka dritat tona,
rrugën kaq të gjerë kurrkush nuk e ka.
Prapanikët janë grimca, milingona,
dashuria jonë — si qielli përmbi ta.

Jo, nuk trembem nga fjalët tinzare,
frikë s'do kem se ty të kam pranë.
Dashura jonë: dritat, fushat, malet,
skutë e tyre është një birucë n'mejhanë...

EJA NË VALLE

Qielli me yje u mbush,
toka me miliona llampa.
Nuk di pse ndjeva veten ngushtë,
për në vallëzim s'më bënin hapat. . .

Në katër horizontet e Atdheut tim
digjej, digjej, posi shkarpat, nata.
Ne këtë qiell dritash e montuam vetë.
E prapë na duhet ca më shumë guxim
që shiritin e inaugurimit
me vallëzimin tonë ta presim shpejt.

Veç zëri yt mua më përmend:
— Eja, në vallen e dritave, eja. . .
Mbështeta kokën në kraharorin tënd,
si, pas shiut,
në një cep të qiellit të larë mbështetet reja.

KRENARI

Unë zbrita nga bjeshkët e buta
në qytetin e madh e plot zhurmë;
në rreshta ushtarësh u futa,
hodha krahëve kapotën e murme.

Unë, vajza e ndrojtur, e urtë,
që marshoj me rrobat ushtarake,
hedh hapin në jetë e sigurtë,
shkel ashpër mendimet tinzake;

dhe kam në zemër kaq zjarr,
që më ndez një qiell dëshirash!
Ndaj atdheut me pushkë në krahë
i rri roje, i mbroj hapësirat!

ZOGJTË E ËNDRRAVE FILLUAN KËNGËN

Ti ike,
ike dhe the
se mua, si një kob i zi,
do ma gërryente shpirtin vetëmia,
se e nesërmja ime me gjurmët e tua do të tretej,
se dashuria ime do të mbetej
si rroba e re,
e kyçur në dollap, ku nga mëria do brehej,
si rroba nga mola...
Kur ike kështu më the.
Dhe, — pse ta fsheh? —
për një çast zogjtë e ëndrrave të mia këngët i
pre në,
ngjyra e fjalëve të mia u zbe,
gjethet e kujtimeve pa vaditur mbenë...

Unë s'doja të ndodhte kështu, po ja, ndodhi!
Vërtet mendimi yt më ra si suferinë,

po fjala s'të doli.

Në aksion unë përtërita dashurinë,

(aty ku më thoshje se s'duhej të shkoja

kursesit...).

Zogjtë e ëndrrave të mia ja nisën këngës përsëri
dhe kujtimet bisqe të rinj buluan plot.

Tashti, ty të pyes: Nga ne kush është më i fortë,
kush është më i ri?

KËNGËTARI E SHOQJA IME

Ai këndonte për detin e gjerë,
për qiellin e kaltër këndonte...
Shoqja ime ish kredhur e tëra
në këngën që diç i kujtonte...

Ne të gjithave na pëlqente shumë
djali, që ish gazmor në jetë e në skenë.
Po, gjer atë çast, ku ta dija unë
se, veç asaj, —
të gjitha thjesht spektatore qemë?

GRUSHTI

Me dridhma agushie erdhi gushti,
me britma, pabesira, tym baruti.
dhe globi u mblodh i fortë, siç mblidhet grushti.

Mbi Pragë ra si meteor helmata.
Me flokët e Lirisë u dogjën dhe gazetata.
Për çekun,
në ulkonjë u shndërrua dhelpëra.

U prenë këngët. U hapën plagët prapë.
Lagjet proletare sy s'mbyllën atë natë,
kur edhe ajri ajër më nuk ish, po kullonte gjak.

Që të mos shuhen yjet e këtij gushti,
që popujt gjithë të thonë: — Ja hajduti...
globi u mblodh shkëmb, siç mblidhet grushti.

UNË JAM SI NJË KËNGË...

Ti e more miqësinë time
si një tingull
që e vërshëllen njeriu
kur mërzitet vetëm...
Po të jesh i bindur:
nuk jam gjeth që më rrëmben veriu,
s'jam burim, që turbullohem lehtë
nga guri i fjalës tënde aq të rëndë...

Unë jam si një këngë
e gëzuar, e fortë.
Po, që ta këndosh bukur atë,
që unë të të thërres shok,
duhet të përgatitesh
të çash dhe më të egërën shqotë!

TELEFONATË NGA MAJA E KUOTËS «X»

Në këtë kuotë vetëm shqiponja ka ardhur nga zogjtë,
nga kafshët-sorkadhja nëpër shkurre rrëshqet.
Ndaj komandanti desh theu telefonin sot,
kur hyri në lidhje me dikë, që s'e kuptonte as vetë...

Ai është me lejë. Po në kuotë është babë e nënë,
e sot atje ka lënë ushtarët e tij trima,
zemrën e tij dhe syrin e tij ka lënë...
Atëher' pse zëri im i shkoi si vetëtima,
që befas shkrep në një natë vere me hënë?

— Nuk është e mundur — thosh me vete ai —
një femër të ngjitet atje, s'është e mundur!
Kurse unë, mes ushtarëve, vëllezërve të mi,
si një komandante isha ulur...

O shoku komandant, mos u shqetëso më kot.
Ti e di: ushtarë s'janë veç ata që ke në organikë.
Dhe unë si ushtarë u ngjita në këtë kuotë,
të mbledh nga heroizmi juaj, ta shpie në revistë
edhe t'u lë si mirënjohje të gjithëve këtë lirikë...

KËPUCARI I ÇETËS

Përmes natës ngjyrë plumbi
në rrugët e ngrira kallkan ai humbi;
ai iku me kolonën që malit iu ngjit,
duke lënë prapa mbi borë radiografitë
e këmbëve të plagosura.

Gishtrinjtë

nguleshin në tokë si kanxha,
sikur të firmosnin: Asnjë hap s'bëjmë prapa!
Ai iku me kolonën që malit iu ngjit
dhe në xhep mbante gjilpërën e vjetër,
pak spango, pak dyllë...
Dhe i therte në zemër këpucarit të çetës,
i dridhej buza këpucarit të mirë
se s'kishte pak shollë, s'kishte lëkurë...
Ai desh t'u ndreqte shokëve këpucët
që as plumbat të mos i shponin dot kurrë;
ai ecte
dhe mbi gjurmët e shokëve, që ishin përpara,
i dilte dyqani i madh e plot dritë.

Pas çlirimit, si zogjtë në brazda,
do mblidheshin rreth në atë dyqan fëmijtë.
Dhe ai do t'u bënte këpucë të bukura, të bardha,
kafe,
e ata do t'i hidheshin të harlisur për qafe...
Ai iku me kolonën që malit iu ngjit
dhe do të sulej pas pak si vetëtimë
mbi ata që shkelnin ëndrrën e tij
me këpucët e urryera alpine!

KUR SHOQJA IME LINDI VAJZË

N. D.


Atë mëngjez dielli nuk lindi nga maja e Dajtit,
atë mëngjez dielli u var nga sytë e tu të kaltër
dhe thirri:

— Erdha!

Në flokët e verdhë atë çast u derdh melodia e
ëndërruar e nënës,
si në muajin korrik puhiza mbi grunjërat e
verdha.

Atë mëngjez gëzimi hidhte valle në katin e katërt,
atë mëngjez qielli i tërë i përkiste nënës sykaltër.

~~124~~
13829



KUJTIM

Të fola në heshtje me sytë e mi,
kur veglat e punës ishim duke larë.
Më kuptove?
Këtë nuk e di,
po s'qenka e thënë që në dashuri
të lidhen dy zemra me vështrim të parë.

Po ç'kuptim kish të kridhesha në melankoli,
gjersa puna,
fitoret në çdo garë
më derdhnin në shpirt melodi?

Dhe mbaroi aksioni,
prapë me atë vështrim të dridhshëm të përçolla.
Nga buzët e mia një këngë e vakët buroi.

A mund të bëja si një qaramane?
Jo, atë që në zemër dot nuk e mbolla,
me vete e mora,
që ta kem si kujtim në shtigje e ormane!

A THUA?

Era përplas grilat e dritares
dhe vjen e përkëdhel flokët e mi gështenjë.
Pres që ti të kalosh duke vërshëllyer një këngë...
Pres që të dëgjoj melodinë e lehtë,
pres dhe kur nata pika qetësie pa mbarim derdh.
Mbi fshatin tim, në çdo kopsht e në çdo pemë
nata bie e kaltër, e hollë si një vel;
era sjell së largu hapin tënd të rreptë,
era derdhe afsh të ngrohtë mbi flokët gështenjë.
Kjo natë sonte është kaq e dashur
dhe sytë e mi më fort se yjet ndrijnë.
A thua yjet sonte ndriçimin nga unë e morën?
Gëzimi më derdhet si lumë i vrullshëm pranvere
kur të pres ty...

TRENDAFILI

Një trëndafil të kuq unë mbolla sot,
në shtëpi të gjyshes, te dritarja pranë,
që më pesë të majit, për çdo mot,
nga një tufë të çoj te dëshmorët tanë.

Kish një djalë dhe gjyshja ime e mirë,
po ra në luftë për të shtrenjtën tokë.
Kur të çelin gonxhet prush në hapësirë,
do shikojë ajo, pranë dritares saj,
një grup me partizanë, që rrinë kokë më kokë...
Dhe do të më flasë: — Çohu, dil, moj bijë,
kanë ardhur djemtë, ja ku rrinë tok...
Dhe unë do ta kuptoj se është 5 maji.

Një trëndafil të kuq e mbolla sot
në shtëpi të gjyshes, te dritarja pranë.
Gjyshja del te praku, në sy nuk ka lot,
kuvendon me mall me trimat partizanë.

VULLNETARES

Dikush të këndoi, si nënë që mëkon trimërinë,
dikush si bujkeshë, që nget qetë në parmendë,
dikush për syrin që shkrep vetëtimë,
dikush...

O motër, jo, unë të këndoj për ty s'e kam rëndë,
se portretin tënd e shikoj aq të plotë sot në trasë.
Virtutet, si bulëzat e djersës, mbijnë atje,
ngjizen atje,
shkrihen atje,
betonohen atje...

Ti, si me tokmak mbi gjithshka të vjetër qëllon
unë udhën e lumturisë çdo ditë e zgjat.

A MBAN MEND?

Të kam pritur një natë,
një natë të kam pritur sa unë e di!..
Litarët e shiut vareshin të lagët, të gjatë,
sikur do masnin durimin tim, dashurinë time për
ty.

E mban mend?

Ti erdhe me vrap duke qeshur. E ç'kish për të
qeshur aty?

Sikur në lagjen tënde të ish tjetër stinë... .

Erdhe që lulet e ndezura të vështrimit të m'i
hidhje mbi krye,

si fishekzaret kur festat na vijnë... .

Nuk mbaj mend sa më vështrove ashtu,

s'di sa gjatë ma mbajte dorën mbi sup,

po kur ngrita kokën lart, pashë qiellin e larë, të
mbushur me yje... .

Po, ti vërtet nga një stinë e ngrohët vije atë natë,

gjersa për dashurinë tonë të pastër
i binde, më në fund, njerëzit e tu.

E mban mend?

Pas kësaj pritje të gjatë
shqiptuam si asnjëherë fjalën «triumf»!

U nisëm për tek ata
dhe ecëm në udhët e lara, nën ritmin e shpejtë të
ujërave që binin në ullukë.

UDHA PLOT TINGUJ U MBUSH

Ti trokite lehtë tek unë
dhe hyre si një mëngjez maji,
duke sjellë aromën e luleve,
freskinë e njomë të barit;

erdhe dhe më qëndron në zemër
si një ushtar i mirë në transhe.
Ndaj dhe kur je larg, ta ndjej zërin
herë të qeshur, herë tek shkrep si rrufe.

Në qenjen time hyre si një këngë
me ritëm të ëmbël e gazmor.
Ëndrrat e mia tashti hodhën rrënjë
thellë, si një lis shekullor.

TI ERDHE

Të pres,
dhe druhem dhe qesh
me vete.
Ajri bëhet çdo çast më i lehtë,
ai mbushet me aromën e takimit tonë. . .

Mbaj vesh,
vështroj rreth e rreth.
Aromën e shpresave të mia dhe gjethi e thith.
Ti erdhe,
s'më erdhe pranë rastësisht.
Nga gjethi në gjeth
dashuria ime erdhi gjer tek ti si puhi
dhe të tha se unë të pres
dhe të tha të bëhesh veri. . .

NË ÇASTIN E NDARJES

Kur ika unë, ti ende mbete aty.
Vështrimi yt i përcjelljes më dërgoi
mijëra porosi,

urime,

lutje,

puthje!..

Atë çast një rrymë e ngrohtë përshkoi
tej e tej gjithë qenjen time.

Nga duart e mia të vockëla atëhere
pikuan urimet si shi i rrëmbyer pranvere...

Atë çast e kuptova se në jetë
s'mund të ketë ndarje për ne,
dhe pse do të ketë

pritje,

përcjellje!

KJO RRUGË

Ai, duke ecur netëve në këtë rrugë,
mbante për këmbë një palë llastika,
që qentë të mos i binin në gjurmë,
qentë e armatosur me kobure dhe thika.

Sot me ekskursionistë
në rrugën «Perlat Rexhepi» eci dhe unë.
Në çdo hap
tufat e buzëqeshjeve mbijnë si lulet kur celin
kajsitë...

Natyrisht,
midis të qeshurave tona gazmore,
më e forta, më e kuqja është e shokut Perlat.
Kur heroi sulmoi me bomba dore,
e ngjeu dhe buzëqeshjen në flakë.

DASHURIA

O, si nuk e di, motër,
ku është tek unë
dashuria?

Ja, vështro:

ky mal,

ai lumë,

ajo kodër

dhe pranë

djali që mban në duar një armë —
se roje e ka Shqipëria.

E PAPËRFUNDUAR

E fshiva atë lule të bukur,
që me aq dëshirë e vizatove ti.
Po, për çudi, petalet si flutura
dridheshin në valle para syve të mi
dhe formonin vizionin tënd,
nga i cili sytë s'i largoja dot.
Në çdo petal lexoja një mendim, një fjalë,
sikur nga zemra jote petalet të kishin dalë.
Dhe unë më kot desha ta shuaj prapë
atë lule, atë emër që më derdhte dashurinë
nëpër gjak!

DËSHIRE

Unë e dua shumë pushkën time,
me të kudo shtigjeve marshoj...
Në beteja, në të ashpërat luftime,
jo, nga dora kurrë nuk do ta lëshoj.
Po edhe në rënça, do bie si një trime,
kurse pushka rishtas këngën do vazhdojë...

DITËLINDJE

Nëndori i dyzet e katrës zbardhi i përcëlluar,
po i larë në ngjyrën e kuqe të flamujve.

Një fëmijë qëllonte me topa bore një maqinë të
blinduar,

që kish mbetur te kthesa si këpucë hajduti...

Horizontet varnin dantellën e kaltër

mbi grykën e pushkës, që binte erë baruti.

Ai fëmija, që qëllonte me topa bore maqinën e
blinduar,

isha vetë unë,

ishe ti, brezi im,

që sot nga universiteti

zbret në poligon me guxim

dhe derdh djersën në transhe

si shkumën e bardhë e derdh brigjeve deti!

PARA PORTRETIT TË DËSHMORIT

Qëndroj para portretit tënd.

Ç'shkëlqim ka në sytë e tu!..

Prandaj dhe është kredhur në dritë sot ky vend.

Ç'forcë ka në krahët e tua, që i mbulon këmishë e
grisur!..

Prandaj dhe oxhaqet e fabrikave
madhërisht kaq lart janë ngritur.

Ç'këngë fitoresh që shkasin mbi buzët e tua të
njoma!..

Po, sirenat e pesëvjeçarëve zgjojnë agimet tona.

SHALLI

Partizanit një yll të kuq, a një shami,
i dhuroi e shoqja, a nëna flokëbardhë.
Po unë ty, i dashur, ç'të të dhuroj tashti
që do shkosh larg? Po ndahemi për herë të parë...

Gjithshka që kam, me kohë ta kam dhuruar,
Ç'kujtim të t'jap? S'të nis dot duarbosh,
më duket se ky çast i përmalluar
do të të nxitë që kurrë të mos m'harrosh.

Pra, merre ti, merre shallin tim.
Dhe nëse ti nuk do kesh atje të ftohtë,
mbështill automatikun kur je në shërbim,
që të të duket se përgjojmë tok.

SHOQES SIME GJEOLIGE

Sa thesarë prekin pëllëmbët e tua
dhe sa gurë, shpesh, i more për mineral...
Shoqe,
nga guximi yt sonte po marr hua,
me një djalë dhe unë jam dashuruar!

Ti gurët një nga një peshon me pëllëmbë,
kurse unë, motër... e kam rëndë.
Ta peshoj nga sytë?
Ata veç rrëzëllejnë.
Ta peshoj nga fjalët?
Ato shpesh gënjejnë.
Ta peshoj nga duart?
Po, i ka të forta.
Ta peshoj nga zemra?

Jo, nuk mundem dot!
Zemra e tij e bardhë e madhe është sa toka...

Shoqe, motër, nga guximi yt unë mora hua!
Shokut tim i thashë sonte: të dua!

DHURATË

Ti ëndërr e pate, o nënë dikur,
(o, ç'ëndërr e varfër që ish!)
të të sillte babai dhuratë
një unazë,
një palë vathë
a dy metra pëlhurë për këmishë...

Nënë,
atë botë, ku dhe ëndrrat ishin gënjeshtër,
e përmbysëm me rrënjë.
As ti s'i pranon lulkat, stolitë,
po domosdo i pranon dhuratat e thjeshta.
Tashti unë vij me lejë dhe të kam prurë
gjerdanin e bardhë të dashurisë sime, o nënë.
Atë do ta ruaj si sytë
që buza ty mos të të dridhet kurrë,
o nënë, e shtrenjta nënë!

PEISAZH

Si një dashnor u përkul dielli
mbi valët e qeta në horizont.
Nga një dorë e butë e bujare
tejendanë u qëndis qielli.
Dhe lundra e hënës zemrat tona i fton
të ndrijnë posi yje brigjeve amtare.

MOTRËS SIME HEROINË

Margarita Tutulanit

«Vdekje fashizmit! Liri Popullit!»

Nga dilte ky zë, nga ç'zemër vallë?
Ç'ishte ky kushtrim që natën u ngrit
si çati e kuqe mbi çdo mëhallë?
Një krismë u ndie. O, ja edhe një.
Armiqtë qëlluan egër mbi të! .

Trupin plumbat ty ta bënë shoshë,
gjaku ty t'u mpi në sy e buzë
e grushtet me polen t'u derdhën përmbi
gjoks.

Era këtë polen lirie
do ta shpërndajë në çdo shteg e udhë!

Motër, ti buzëqesh me sytë prush nën
qerpikë,
zemra më fort po ta rreh gjinë.
Në sytë e tu të ndritur, Margaritë,
unë pashë vallen e gëzimit n'atdheun tim.

Ti buzëqesh, ti shikon
Shqipërinë që ngjitet nëpër kaltërsi.
Mbi ballin e saj një diell qëndron,
dielli që ëndërrova në atë natë ti.

«Vdekje fashizmit! Liri popullit!..»
Përsëri e ndiej unë këtë zë,
dhe shkulmi i zërit tënd i madh,
jehonë për gjeneratën tonë u bë!

RRUGICA IME NË PARKUN E RI

Rrugica ime, përse po hesht,
kur unë kaloj përmbi asfalt?
Mos vallë vështrimi yt pret
dy siluetat të duken bashkë?

Apo ke rënë në qetësi
dhe buzëqeshjet pret e lumtur?
Në zhurmën që ruan në gji
të ngrohtë mbetën zërat tanë,
siç mbet mbi buzën time një e puthur!..

Ja, unë po ulem mbi sofat,
aty ku bashkë dje na vështroje.
Po, nëse unë sot jam fillikat,
përreth shiko, gumzhijnë dhjetëra zgjoje...

Rrugicë, rrugica ime!
Nesër prapë dy siluetat
do pëshpërisin fjalë të gjelbra.
Rrugica ime,
dashuria ime!

Ja, nuk e ndjen?
Po vjen ai,
e unë ka kohë që erdha.
Rrugica ime,
dashuria ime,
s'të shkojnë ty gjethet e verdha...

NË BREGDET

Ranishtja e përvëlur
m'i digjte këmbët e zbathura.
Dhe pranë një djalë mbi mua kish lëshuar
rrezet e vështrimeve të kaltra.
Si të shpëtoja unë nga vapa?

Hyra në det, u zhyta thellë.
Po prapë një prush i kaltër më kish mbështjellë.
Dhe, aty për aty, më lindi vargu im:
Në bregdet
dhe rëra dhe jodi dhe vala
në dashurinë e parë bëjnë pjesë.
Kaq e gjerë, e ngrohtë, e thellë
dashuria jonë do të mbetet për jetë!

PARTIZANI I VOGËL

Ai dilte nga shtëpia ndajnate;
në mure,
në rrugica,
në shtylla ndizte zjarret e kuqe të trakteve!

Po e panë,
e qëlluan,
e vranë;
iu afruan
po ikën të tmerruar banditët italianë.

Ç'i trembi të çeliktat helmata,
ç'i trembi të barbarit cfungji?
Partizani i vogël
përmes kaçurrelave të veta
kish derdhur vetëtimën e vështrimit të tij!

AI

Ai s'u kthye nga lufta.

Si?

Jo, nuk është e vërtetë!

Në se mungon kur shtrohët buka,
kjo do të thotë se ende sulmin vazhdon;

në se mungon ndonjë ditë në festë,
sigurisht,

ai rri ende me syrin në shqekëz në pritë...

Kurse në marshim, më thoni, kur ka munguar?

Në çdo mal e kodër, në çdo shteg

atë e kemi takuar

të shndërruar në monument!

KUR MË PËRCOLLI NËNA

Kur më përcolli nëna si ushtarë,
sapo zbardhi dita.
Meloditë e mëngjezit pranveror
i thitha,
me to mbusha kraharorë
dhe nëpër shtigjet e kalitjes ika.

Kur më përcolli nëna,
për herë të parë serioze pëshpërita
fjalën: u rrita!
Dhe m'u duk se njerëzve bashkë me
përshëndetjen
u thoshja dhe «u rrita!»
Dhe për ata nuk isha më një vajzë çapkëne,
po shoqja Merita!..

Kur më përcolli nëna,
mbi buzë më fërfëlloi e ngrohtë kënga.

INTIME

Në asfalt
qëndronim ne të dy.
Qielli i kaltër, i kaltër
na shpalosej në sy.
Në buzën time atë çast
fërfëronte ëmbël «Kasta diva».
E ti i rrëmbeje tingujt
i gëzuar, i bindur,
sikur të mblidhje aty trëndafila.
Nga tingujt
na bëhej dhe vetë dashuria.

KUR MORA URIMIN TËND

Prisja pranë bredhit, që shkëlqente nga dritat,
urimin tënd, me padurim e prisja,
siç prisnin të gjithë orën dymbëdhjetë,
agimin e një viti të ri, të një dite të re.
Dhe s'vonoi të hynte urimi yt çapkën
së bashku me vizionin e fytyrës tënde të qetë,
dhe ish aq i ngrohtë ai urim,
sa dhe borën maleve m'u duk se e shkriu
dhe solli pranverë anakënd.
Atë çast lulëzoi, në dritaren time,
një degë me lule të bardha molle...
Hapa kanatet të përshëndesja e para pranverën.
Atëhere mbi flokët e mi gështenjë
binin pareshtur lule të bardha molle.
Dhe kështu dashuria jote
si pranvera
në kraharorin tim do të mbetet në mote!

SHTIGJE TË VITIT TË RI

Malet pranë e pranë rreth sofrës së dimërit rrinë në
radhë.
S'është bora ajo, po gëzimi ynë që rrjedh nga shpirti
i bardhë.

Malet presin aksione të reja, kazma, gjeologë, sonda,
siç presim ne një urim, që duhet të na vijë, gjer
në orët e vona.

Fushat janë mbjellë, kokrrat kanë lidhur, gruri diku
ka buluar.
Ato presin t'i ngrohë shalli i gjelbër, si ne kur
takojmë duart.

Traktorët, që çajnë në kodra, herë-herë kokën pas
e kthejnë
dhe u duket sikur zërin e njohur të fushave ndiejnë.

Kantieri i ri me çimento, trarë, tulla, maqina ngado
ngutet mes zhurmave të dashura, si unë, kur ti më
thua: — Nxito!

Tashti ky kantier i thjeshtë asnjërit vëmendjen s'ja
tërheq,
kurse nesër do të nxitojnë mijëra ekskursionistë, të
rinj e pleq.

Telat e tensionit të lartë tejendanë fushës, të lagur,
shkëlqejnë,
sikur këngën e florinj të Fierzës të parët të
ndiejnë.

Vau i Dejës kollitet për herë të fundit, i kredhur në
punë,
si ne, kur bëhemi gati të themi fjalën e menduar aq
shumë!

Pishkashi, i kredhur në purpur, pret të dëgjojë
sirenën,
siç pret gjyshja ime që unë me të fejuarin t'i shkoj
të dielën.

Ja, po vjen ajo ditë. Më pranë do ta sjellë viti i ri...
Dhe, kur të dëgjojë Pishkashi sirenën, pritna, gjyshe,
neve dhe ti...

Malet pranë e pranë rreth sofrës së dimërit rrinë
në radhë.

S'është bora ajo, po gëzimi ynë që rrjedh nga shpirti i
bardhë.

Sonte secili nga ne në shtigje të reja çan.
Sa të shndritshme, sa të lumtura gjithë shtigjet janë!

PASQYRA E LËNDËS

Faqe

Partisë.	3
Ecim në asfaltin e dritave	4
Eja në valle	6
Krenari.	7
Zogjtë e ëndrrave filluan këngën	8
Këngëtari e shoqja ime	10
Grushti.	11
Unë jam si një këngë	12
Telefonatë nga maja e kuotës «X»	13
Këpucari i çetës	15
Kur shoqja ime lindi vajzë	17
Kujtim.	18
A thua?	20
Trëndafili	21
Vullnetarës.	22
E mban mënd?	23
Udha plot tinguj u mbush	25
Ti erdhe	26
Në çastin e ndarjes	27
Kjo rrugë	28
Dashuria.	29
E papërfunduar	30
Dëshirë.	31
Ditëlindje.	32

Para portretit të dëshmorit	33
Shalli.	34
Pema.	35
Shoqes sime gjeologe	36
Dhuratë	38
Peisazh.	39
Motrës sime heroinë	40
Rrugica ime në parkun e ri	42
Në bregdet	44
Partizani i vogël	45
Ai.	46
Kur më përcolli nëna	47
Intime.	48
Kur mora urimin tënd	49
Shtigje të vitit të ri	50

Tirazhi 1500 kopje

Format 70x100/32

Stash: 2204-65

Shtyp. NISH. Shtypshkronjave «MIHAL DURI»
Stabilimenti «8 NENTORI» — Tiranë, 1971